



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 52, datë 21.06.2019

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN DHE CAKTIMIN E
PIKËVE PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR INSPEKTOR I LARTË I
DREJTËSISË**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratohet Metodologjia për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI
Arrian Dvorani